



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK.

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nr. 7-180/01
Datë: 14.01.2021

Duke u bazuar në nenet 12 dhe 68 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport hedh në:

DISKUTIM PUBLIK

RREGULLORE E KOMUNËS SË JUNIKUT PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Duke pasur parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimeve me qytetar dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të tyre në propozimet për vendimet me interes të qytetarëve.

Andaj, Drejtoria për AKRS në Komunën e Junikut rregulloren për “Përkujdesjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, e hedh në diskutim publik nga data 14.01.2021 deri më 28.01.2021.

Vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe komentet e juaja mund t'i dorëzoni në Zyrën e Arsimit në Objektin e Komunës zyra Nr. 16 (në katin e dytë), ku edhe mund të siguron materialin për shqyrtim, çdo ditë pune prej orës 09:00 deri në ora 12:00. Këtë dokument mund ta gjeni edhe në faqen zyrtare të Komunës <https://kk.rks-gov.net/junik/>

Drejtori i Drejtorisë për AKRS

Z. Fatos Shala

